



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 82/2012
Prishtinë, më 12.11.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Sala Berisha–Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Teuta Luboteni, Rexhep Bllaca, Agron Shurdhani, Sebahate Bushrani dhe Isa Elshani – MTI; Dita Dobranja dhe Dardan Abazi – INDEP; Miranda Shala - Ambasada Britanike; Florije Mehmeti – KDI; Enver Pakashtica dhe Gëzim Muriqi –SHAAC.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 06.11.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.11.2012

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 06.11. 2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara

Kryetari – Tha se për Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara, që është shqyrtuar edhe në mbledhjen e kaluar, jemi pajtuar që ta vizitojmë Departamentin e Metrologjisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe ndërmarrjen private “Finesa” në Prishtinë. Ne si Komision ishim në këto dy vizita, ku qëllimi i tyre ishte për të marrë për së afërmi informata shtesë se si funksionon në vendin tonë industria e metaleve të çmuara, si dhe çfarë kapacitetesh administrative e shtetërore kemi në këtë drejtim. Pastaj, fjalën ia dha znj. Teuta Sahatqija, kryesuese e grupit të punës, për ta prezantuar raportin me propozim-amendamente të Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara.

Teuta Sahatqija - Tha se grupi i punës ka mbajtur dy takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe me përfaqësuesit e shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve të Kosovës, një dëgjim publik, ndërsa një takim e ka mbajtur vetëm grupi i punës, dhe po ashtu, ka realizuar dy vizita. Theksoi se gjatë vizitës që kemi pasur në Departamentin e Metrologjisë, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe ndërmarrjen private “Finesa” në Prishtinë, u njoftuam nga Departamenti Metrologjisë për mënyrën e punës që e bën ky departament, se si kontrollohen dhe si u bëhen analizat produkteve nga metalet e çmuara. Po ashtu, edhe në ndërmarrjen private “Finesa” në Prishtinë, që merret me prodhimin e metaleve të çmuara, se si shkon mënyra e prodhimeve të produkteve nga metalet e çmuara, siç është ari etj. Por, një çështje që ka mbetur ende e hapur për ta diskutuar në Komision, është çështja e vulës shtetërore apo shenja e harmonizimit, apo neni 8, përkatësisht amendamenti 11, ku ka pasur mospajtime në mes të përfaqësuesve të MTI-së dhe përfaqësuesve të shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve. Prandaj, ne po mundohemi të gjejmë një zgjidhje për të dy palët, që ka të bëjë drejtpërdrejt me zbatimin e Ligjit për punimet nga metalet e çmuara.

Rexhep Billaca (MTI) – Kërkoj që të fshihet **paragrafi 3 nga amendamenti 9**, ku thuhet se Departamenti i Metrologjisë vendos si organ i fundit. Ai tha se në rast të kontekstit të ndonjë çështjeje, duhet të jetë gjykata kompetente, sipas amendamentit 17, e jo Departamenti i Metrologjisë, që duhet të marrë vendime të fundit.

Lutfi Zharku – Në parim, Departamenti i Metrologjisë është organi profesional dhe vendos për çështjet e fushës së kontrollit të cilësisë, ndërsa gjykatat vendosin në ato rast kur palët ankohen dhe atëherë mund të zhvillohet procedura nëpër gjykatat kompetente.

Visar Ymeri – Tha se, edhe pse e kemi shtuar një amendament, atë të 17- in, këto të dyja nuk e përjashtojnë njëra –tjetrën, sepse siç e potencoi z. Zharku, janë çështje të ndara se kur dhe për çka vendos Departamenti, e për çka gjykata kompetente.

Propozimi i MTI-së nuk u përkrah nga Komisioni.

Sebahate Bushrani (MTI) – Në lidhje me amendamentin 11, që rregullon nenin 8, dha arsyet pse duhet të jetë vula shtetërore në Ligjin për metalet e çmuara. Ajo tha se gjatë inspektimit në shitoret e argjendarëve, ku janë marrë mostrat për cilësinë dhe pastërtinë e arit, kur janë dërguar në laboratorin e metrologjisë për analizë, për të verifikuar cilësinë dhe pastërtinë e arit, ka dalë se shumica e arit është nën vlerën më të ulët të cilësisë, e cila është deklaruar nga pronarët e argjendarive. Prandaj, ajo theksoi se është e domosdoshme që në këtë ligj për metalet e çmuara, të mbetet vula shtetërore për ta kontrolluar më mirë këtë veprimtari që po zhvillohet në Kosovë.

Enver Pakashtica (kryetar i shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve) - Tha se shumica e argjendarëve janë vetëm përpunues të metaleve të çmuara dhe këta kanë vulën vet me shifra. Propozoi që këto biznese, që merren vetëm me përpunim e metaleve të çmuara, siç është ari dhe argjendi, të mos detyrohen që ta vendosin edhe vulën shtetërore.

Myzejene Selmani - Tha se duhet të kemi kujdes lidhur moslejimin e vakumit në ligj, lidhur me atë që thotë shoqata e Argjendarëve, në shumicën rasteve, kjo veprimtari është vetëm përpunuese. Ajo theksoi se duhet të bëhet harmonizimi i Ligjit për metalet e çmuara, për prodhuesit e metaleve të çmuara dhe për përpunuesit e arit.

Agron Shurdhani (MTI) - Në kuadër të Ligjit për metrologji, është e rregulluar se Departamenti i Metrologjisë mund të autorizojë, në rast nevojë edhe trupa të tjerë inspektues. Ndërsa, me këtë ligj, kjo çështje do të rregullohet me akte nënligjore.

Lutfi Zharku - Tha se nuk pajtohet me atë çka po kërkohet tani nga ana e përfaqësuesve të Departamentit të Metrologjisë, sa i përket vulës shtetërore. Pra, që Departamenti i Metrologjisë mund të autorizojë trupa të tjerë inspektues apo ndonjë kompani, në emër të shtetit të vendosë vulën shtetërore. Kërkoi që mos të lihet me anë të Ligjit të krijohet monopol për këtë veprimtari, sepse shteti e ka shumë më të vështirë për ta kontrolluar këtë sektor.

Visar Ymeri - Tha se lidhur me këtë që po propozohet tani nga ana e përfaqësuesve të MTI-së, po dilet jashtë draftit të propozuar të Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara. Dhe, këtë çështje është më mirë që institucionet shtetërore ta kenë nën përgjegjësi, sepse është edhe më lehtë për inspektoratin të mbikëqyrë këtë veprimtari, e jo të autorizohet ndonjë kompani private për ta kontrolluar këtë fushëveprimtari.

Fikrim Damka – Tha se është kundër vulës shtetërore që të mbetet në Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara, sepse MTI-ja, vetëm me një laborator të metrologjisë, nuk mund të kontrollojë analizën e pastërtisë dhe vlerës së çdo produkti nga ari. Ai tha se, nëse mbetet vula shtetërore në ligj, kjo do t'ju krijojë probleme për punë të gjitha bizneseve që merren me këtë veprimtari.

Kryetari – Kërkoi që të formulohet amendamenti 8, që të gjendet një mes ku nuk dëmtohen as bizneset që merren me këtë lloj zeje. Gjatë vizitës që e realizuam në ndërmarrjen prodhuese të arit, u informuam që është një zanat goxha i vjetër në vendin tonë dhe është i trashëguar brez pas brezi, andaj duhet të kemi konsideratë dhe të jemi të kujdesshëm.

Teuta Sahatqija - Propozoi që të qartësohet dhe më në detaje amendamenti 11, në mënyrë që gjatë zbatimit të Ligjit, mos të ketë konfuzion as nga Departamenti i Metrologjisë, por as nga shoqata e Artarëve dhe Argjendarëve, që i mbrojnë interesat e të gjitha bizneseve që merren me këtë veprimtari, pra që mos ta dëmtojë këtë biznes.

Lutfi Zharku – Propozoi që të shtohet edhe një paragraf i ri në nenin 8 si vijon: “6. Shenjën e harmonizimit e vendos vetëm laborator i metaleve të çmuara, në kuadër të Drejtorisë së Metrologjisë”.

Komisioni me tre (3) vota për, dy (2) kundër dhe një (1) abstenim, miratoi amendamentin 11 me propozimin e z. Zharku.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohen amendamentet për Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara.*
- 2. Raporti me amendamente u dërgohet komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.*

4. Të ndryshme
Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit